



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 26 nëntor 2025 miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit dhe pranoi në prova pesë deklaratat dëshmitari të dhëna nga një dëshmitar përpara dëshmisë së tij në gjykatë. Trupi Gjykses lejoi pranimin e deklaratave në prova vetëm për të verifikuar përputhshmërinë e deklaratave të dëshmitarit të cilat mund të kenë ndikim mbi peshën dhe besueshmërinë që do t'i jepet dëshmisë së dëshmitarit në kuvendimet përfundimtare.

Më 1 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Krasniqit për pranim në prova të 144 materialeve që nuk kanë të bëjnë me asnjë dëshmi të dëshmitarëve. Trupi Gjykses pranoi në prova 112 prej këtyre materialeve dhe refuzoi 32 prej tyre pasi këto materiale kundërshtohen, nuk janë relevante për akuzat, ose Mbrojtja nuk ka vërtetuar se si këto materiale janë relevante për akuzat. Trupi Gjykses, duke vepruar sipas kompetencës që ka, pranoi disa prej provave materiale të propozuara në rastet kur identifikoi informacion relevant në materiale jorelevante. Trupi Gjykses u rikujtoi palëve që, në parashtrimet e tyre përfundimtare, të identifikojnë qartë materialet mbi të cilat ato mbështeten në argumentimet e tyre dhe vlerën provuese dhe rëndësinë që i japin secilës provë.

Gjithashtu më 1 dhjetor, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për pranim në prova të 166 materialeve që nuk kanë të bëjnë me asnjë dëshmi të dëshmitarëve. Trupi Gjykses pranoi 149 prej këtyre materialeve dhe refuzoi 17 prej tyre me konstatimin se ato nuk janë relevante për krimet për të cilat janë ngritur akuza në këtë çështje, ose sepse Mbrojtja nuk shpjegoi relevancën e tyre në lidhje me ndonjë fakt apo rrethanë në këtë çështje.

Më 2 dhjetor Mbrojtja e Hashim Thaçit dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit mbyllën formalisht paraqitjen e provave të tyre dhe bënë më dije se nuk synojnë të thërrasin dëshmitarë të tjerë apo të paraqesin prova të tjera.

Më 3 dhjetor, Trupi Gjykses lëshoi një vendim në lidhje me faktet për të cilat palët janë pajtuar. Në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, Trupi Gjykses mund t'i konstatojë këto fakte si të vërtetuara, përveç nëse mendon se për faktet e pretenduara duhet të paraqiten prova më të plota. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vuri në dukje se jo të gjitha palët u pajtuan për të gjitha faktet në fjalë dhe nuk pranoi ato për të cilat nuk pati pajtim unanim nga palët. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi si të vërtetuara 29 fakte dhe nuk pranoi 20 të tjera.





Trupi Gjykses caktoi datën 19 janar 2026 si afat për Prokurorinë dhe Mbrojtjen për dorëzimin e dosjeve të tyre përfundimtare, dhe për dorëzimin nga Mbrojtja e Viktimave të deklaratës mbi pasojat e krimeve të pretenduara për 155 viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.

Fjalët përfundimtare janë caktuar të paraqiten nga data 9 deri me 13 shkurt 2026, dhe datat 16 dhe 18 shkurt janë rezervuar në rast se fjalët përfundimtare marrin më shumë kohë seç pritet.

Pas fjalëve përfundimtare Trupi Gjykses do të mbyllë çështjen dhe do të fillojë kuvendimet për nxjerrjen e aktgjykimit. Aktgjykimi duhet të shpallet brenda 90 ditësh nga mbyllja e çështjes. Në rast se rrethanat kërkojnë kohë shtesë, ky afat mund të zgjatet me 60 ditë.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt Fadil Fazliut, dhe Hajredin Kuçit, lidhur me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 2 dhjetor Gjykatësi i Vetëm miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të kërkuar informacion të mëtejshëm në lidhje me një raport të një instituti të jashtëm për kriminalistikë në lidhje me kërkimin e një deklarate konkrete në të dhënat dixhitale të nxjerra nga printerat dhe kompjuterat që pretendohet të jenë përdorur nga Hashim Thaci në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Mbrojtja nuk e kundërshtoi këtë kërkesë.

Më 3 dhjetor, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaci, z. Smakaj, dhe z. Fazliu. Ndonëse nuk konstatoi dhe nuk mori parasysh rrezikun e arratisjes për asnjërin prej të akuzuarve, Gjykatësi i Vetëm konstatoi praninë e rrezikut real se të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit dhe konstatoi se në këtë fazë të procesit, vetëm masat në fuqi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara mund të zvogëlojnë ndjeshëm mundësinë e ndikimit ndaj dëshmitarëve.

Gjatë seancës përgatitore që u mbajt më 28 nëntor, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një urdhër gojor në të cilin urdhëroi Prokurorinë të dorëzojë mocionet e saj për provat që nuk kanë të bëjnë me ndonjë deklaratë dëshmitari, deri më 17 dhjetor 2025.

